



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
GRAMSH

Nr. 1024

Gramsh, më 07/03/2023

Vendim

Nr. 22, dt. 07.03.2023

Për

Miratimin e shumës së bashkëfinancimit për projektin e përmirësimit të banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara

Këshilli i bashkisë Gramsh në mbledhjen e tij të datës 07 03.2023, pasi mori në shqyrtim relacionin e drejtorisë së Shërbimeve me Sipërmarrje, Transporte, Strehimi dhe Emergjencave Civile si dhe drejtorisë së Financës dhe Buxhetit “Për miratimin e shumës së bashkëfinancimit për projektin e përmirësimit të banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara”, në mbështetje të ligjit nr.22/2018, datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, në VKM nr. 454, datë 03.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat e përfitimit dhe dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”, në Udhëzimin e MFE, nr.31, dt.18.11.2019, “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit, të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, pika 2;

Vendos:

- I. Të miratohet shuma e bashkëfinancimit për projektin e përmirësimit të banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara në masën 3 061 144.82 lekë, për 12 familje në nevojë bazuar në programet sociale për strehimin e banorëve të bashkisë Gramsh me qëllim përfitimin e fondeve buxhetore.
- II. Të pakësohet vlera 3 061 144.82 lekë, nga shuma e përcaktuar me vendimin e këshillit bashkiak Nr.103, date 27.12.2022 “Për miratimin e programit buxhetor për vitin 2023”, pasqyra nr.2 me zërin bashkëfinancime për investime.
- III. Të shtohet shuma 3 061 144.82 lekë për bashkëfinancim për projektin e përmirësimit të banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë, drejtorja e shërbimeve publike dhe emergjencave civile, drejtorja e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit të Bashkisë
Xhulia GJINI

Konc.Xh.Gjini
Konf.G.Lena
Dosja: _____
Afati I rraJjtes: _____

Kryetari i Këshillit të Bashkisë
Greta LENA

